



---

REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AUTORITETI I KONKURRENCËS

### NJOFTIM PËR SHTYP

Sot me datë 23 nëntor u çel Konferenca Ndërkombëtare me temë “20-vjetori i ligjit “Për mbrojtjen e konkurrencës” në Shqipëri: Pavarësia dhe roli i autoritetit në reformën rregullatore, zbatimi i ligjit, advokacia dhe sfidat drejt Integritimit në Bashkimin Evropian”.

Në kuadër të promovimit të kulturës së konkurrencës dhe 20 vjetorit të rrugëtimit të Shqipërisë në mbrojtje të konkurrencës së lirë dhe efektive në treg, kjo konferencë mbledhi së bashku ekspertë të autoriteteve homologe nga rajoni dhe Evropa; përfaqësues nga pushteti legjislativ, ekzekutiv dhe gjyqësor; organet rregullatore, përfaqësues nga dhomat e tregtisë, si dhe pjesëmarrës nga bota akademike dhe e biznesit.

Konferenca u përshendet nga Kryetari i Autoritetit të Konkurrencës, Z. Denar Biba; Kryetari i Komisionit të Ekonomisë dhe Financave, Z. Eduard Shalësi; Guvernatori i Bankës së Shqipërisë, Z. Gent Sejko; Përfaqësuesi i UNDP në Shqipëri, Z. Francisco Roquette dhe Zëvendës Ambasadori i Gjermanisë në Shqipëri, Z Thilo Schroeder.

Gjithashtu u zhvilluan diskutime të hapura në tre panele me tema si pavarësia e institucionit dhe roli i tij në reformën rregullatore, sfidat drejt integritimit në Bashkimin Evropian, bashkëpunimi ndërkombëtar dhe zbatimi i ligjit të konkurrencës: antitrust dhe përqendrime.

Konferenca do të vazhdojë punimet nesër me ditën e dytë me panele, diskutime dhe të ftuar dhe ekspertë të tjerë të autoriteteve homologe nga rajoni dhe Evropa.

Për më tepër, ju lutem konsultoni faqen zyrtare të Autoritetit të Konkurrencës në <http://caa.gov.al>.